

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 241 Prot.

Tiranë, më 21 / 03 /2023

VENDIM

Nr. 55, datë 21 .03.2023

PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR. 54, DATË 09.03.2023 “PËR FILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJEVE E DREJTUESËVE TË NJËSIVE BAZË NË FAKULTETIN E MJEKËSISË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Në zbatim të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 të Senatit Akademik “Për miratimin e Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik të UMT me nr.11, datë 10.02.2023 dhe në Urdhrin të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë nr. 27, datë 21.02.2023 “Për shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor për zgjedhjen e drejtuesve të njësive bazë (Departamenti i kirurgjisë dhe në Departamentin e obsetrikë-gjinekologjisë) në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë”, i ndryshuar me Urdhrin nr. 40, datë 20.03.2023 “Për një ndryshim në urdhrin 27 datë 21.02.2023, përcjellë me shkresën e Rektorit të UMT-së nr. 2695/12 prot., datë 20.03.2023 “Përcillet për njohje dhe zbatim ...” si dhe Vendimin e KIZ nr.54, datë 09.03.2023 “Për fillimin e procesit zgjedhor ...”, KIZ në mbledhjen e datës 21.03.2023;

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 2 të Vendimit nr. 54, datë 09.03.2023 “Për fillimin e procesit zgjedhor për përzgjedhjen e drejtuesve të njësive bazë në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.” si më poshtë:

“2. Të miratojë periudhën e zhvillimit të procesit zgjedhor nga data 23.02.2023 deri në 27.03.2023 dhe datën 27.03.2023 datën e votimit për zgjedhjen e drejtuesve të njësive bazë sipas pikës 1 të këtij vendimi.”

2. Ti kërkohet KZF-së dhe Fakultetit të Mjekësisë të publikojë dhe shpallë njoftimin për ndryshimin e datës së votimit që do të zhvillohen për drejtuesit e njësive bazë, duke njoftuar kandidatët pjesëmarrës si dhe të gjithë anëtarët e personelit akademik të Departamentit të Kirurgjisë dhe Obstetrikë-Gjinekologjisë në FM, për ndryshimin e datës së zgjedhjeve, më 27.03.2023.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në mjediset e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT dhe një kopje e tij i dërgohet KZF të Fakultetit të Mjekësisë, UMT.

KRYETAR
SILVANA BALA

